



AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KOMPETENCAT

Drejtori i Përgjithshëm ushtron kompetencat e mëposhtme:

- Drejton, organizon, koordinon dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë e ADB-së sipas strukturës dhe të organikës së miratuar me urdhër të Kryeministrit.
- Përcakton objektivat vjetore të ADB-së, në përputhje me objektivat strategjike të miratuar nga Kryeministri dhe harton planin vjetor të punës së institucionit.
- Drejton procesin e planifikimit buxhetor dhe të raportit vjetor të punës.
- Drejton punën për përgatitjen e rregullores dhe kodin e etikës së institucionit dhe e dërgon atë për miratim te Kryeministri.
- Drejton grupin GMS, Grupi i Menaxhimit Strategjik, dhe përcakton objektivat strategjike të institucionit.
- Miraton programin vjetor financiar të institucionit.
- Miraton përshkrimet e vendit të punës për rekrutimin e punonjësve të ADB-së dhe emëron dhe liron nga detyra punonjësit në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.
- Nxjerr akte administrative për realizimin e funksioneve të ADB-së, të detyrueshme për punonjësit e saj.
- Nënshkruan marrëveshje me njësitë e vetëqeverisjes vendore apo institucione, organe të tjera publike, vendase ose të huaja, në përputhje me parashikimet ligjore, si dhe miraton pjesëmarrjen në aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare sipas marrëveshjeve të nënshkruara.
- Delegon me shkrim kompetencat, në rast të mungesës së tij.
- Nxjerr urdhra dhe udhëzime në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore për funksionimin e agjencisë.
- Miraton programin vjetor të aktiviteteve të drejtorisë COD.
- Përfaqëson agjencinë në marrëdhënie juridike me të tretët dhe mediat, brenda dhe jashtë vendit.
- Raporton në mënyrë periodike dhe sa herë që kërkohet nga Kryeministri për veprimtarinë e institucionit.